

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA
XXXXX

Nr. 12 Rregjistri

Nr. 10 Vendimi

Datë 23.06.2011

Datë 03.11.2011

VENDIM -

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Xxxxx, me trup gjykues të përbërë prej gjyqtarëve:

Liljana	BAKU	K/ trupit gjykues
Dritan	HALLUNAJ	Anëtar
Fran	PRENDI	Anëtar

Asistuar nga sekretare seance **Andina KAJA**, sot në datë 03.11.2011, përfundoi në seancë gjyqësore publike, gjykimin e kërkesës **Nr. 12 Rregjistri** që i përket palëve:

KËRKUES:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Xxxxx, përfaqësuar nga prokurori **A. XH.**

KUNDËR

SHTETASVE:

1.V. H. , i biri i D. dhe i H. , i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në xxxx dhe banues në fshatin xxxx xxxx, me shtetësi shqiptare, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, aktualisht duke vuajtur dënimin në Institucionin e Ekzekutimit të Dënimeve Penale Lushnjë, përfaqësuar nga Av.Xh. M., me Nr. Liçense XXXX, Nr. Nipti X. XXXXXX X, anëtar i Dhomës së Avokatisë Fier.

2. D. H., i biri i S. dhe i Xh. , i datëlindjes xx.xx.xxxx, lindur në fshatin xxxx xxxx dhe banues në fshatin xxxx xxx, me shtetësi shqiptare, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbrojtur nga mbrojtës i zgjedhur me deklaram në seancë, Av.Xhevair Morina, me Nr. Liçense XXXX, Nr. Nipti X. XXXXXX X, anëtar i Dhomës së Avokatisë Fier.

OBJEKTI:

I.Konfiskimi i pasurive:

I.1 Pasuri e paluajtshme “Njësi tregtare”, me sipërfaqe xxx.x mx, Zona Kadastrale xxxx, me numur pasurie x/xx-xx, Vol.x, Faqe xx, Indeksi i hartës xx-xx-xx, e cila ndodhet në katin përdhe të një pallati x-katësh në Lagjen “xxxxxxx” të qytetit të xxxxx, pasuri e blerë nga shtetasi D. H. (babai i të dënuarit V. H.), sipas Kontratës së Shitblerjes me Nr.xxx Rep. dhe xxx Kol, datë xx.xx.xxxxx në shumën prej 1.900.000 lekë.

I.2.Pasuri e paluajtshme “Njësi tregtare”, me sipërfaqe xx.x mx, Zona Kadastrale xxxx, me numur pasurie x/xx-xx, Vol.x, Faqe xx, Indeksi i hartës xx-xx-xx, e cila ndodhet në katin përdhe të një pallati x-katësh në Lagjen

“xxxxxxxxx” të qytetit të xxxx, pasuri e blerë nga shtetasi D. H. (babai i të dënuarit V. H.), sipas Kontratës së Shitblerjes me Nr.xxx Rep dhe xxx Kol, datë xx.xx.xxxxx në shumën prej 1.000.000 leke.

II.Për administrimin dhe përdorimin e këtyre pasurive të ngarkohet **Z.D. Sh.** , i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë ndërsa, për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbartimit Fier.

BAZA LIGJORE:

Ligji Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, në përfundim të gjykimit, në kushtet e qënies së saj kompetente për të gjykuar dhe vendosur në bazë të nenit 7 pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, pasi shqyrtoi provat e paraqitura dhe të marra në gjykim, dëgjoji pretendimet përfundimtare të palëve në të cilat u kërkua:

Prokurori A. Xh.:

Pranimin e kërkesës, konfiskimin e dy objekteve, njësi tregëtare së bashku me pajisjet të ndodhura brenda tyre, sipas përshkrimit në objektin e kërkesës dhe, në procesverbalin e inventarizimit të datës 07.01.2011, përpiluar nga përmbartuesi i Zyrës së Përmbartimit Fier.

Për administrimin dhe përdorimin e këtyre pasurive të ngarkohet **Z. E. B.** , i cili është administrator në Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë ndërsa, për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbartimit Fier.

Shpenzimet proceduriale të kryera deri tani në shumën 230.261.84 (dyqind e tridhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një, pikë tridhjetë e katër) lekë si dhe, shpenzimet gjyqësore të ngarkohen personit të tretë D. H.

Mbrojtësi, Av. Xh. M. : Rrëzimin e kërkesës me objekt konfiskimin e

pasurisë dhe, heqjen e masës së sekuestros të vendosur mbi to.

Shtetasi D. H. : Dakort me mbrojtësin

V Ë R E N

Shtetasit V. dhe D. H. , nga fshati Drizë i rrethit të Fierit, kanë lidhje gjinore të afërt midis tyre duke qënë at e bir.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane, në datë 22/04/2010, ka rregjistruar procedimin pasuror Nr. 3 në ngarkim të shtetasit V. H. Rregjistrimi i procedimit është bërë mbi bazën e materialeve të dërguara nga Prokuroria e Përgjithshme, me Shkresën Nr.2392/8 Prot, datë 19/04/2010. Nga përmbajtja e tyre ka rezultuar se Gjykata e Apelit Vlorë, me Vendimin Nr.51, datë 12/03/2009, ka lënë në fuqi Vendimin Nr. 404, datë 14/11/2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me objekt “Njohjen e Vendimit Penal Nr.2858, datë 13/06/2005 të Gjykatës së Apelit të Milanos-Itali, të dhënë ndaj shtetasit shqiptar V. H.”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me Vendimin Nr. 404 datë 14.11.2008, ka pranuar kërkesën e Prokurorisë duke njohur Vendimin Penal Nr. 2858 datë 13.06.2005 të Gjykatës së Apelit të Milanos Itali për shtetasin V. H. sipas të cilit, ai është dënuar njëzet e katër vjet burgim për kryerje të veprave penale “Organizata kriminale” dhe “Trafikimi i narkotikëve”, të parashikuara si të tilla në nenet 110-81, 73/1, 6 - 80/1/d, 2 të Kodit Penal Italian si dhe, në nenin 74/2 të Dekretit të Presidentit të Republikës Italiane Nr.309/1990. Pas konvertimit të dënimit, shtetasi V. H. është dënuar përfundimisht me nëntëmbëdhjetë vjet burgim, në zbatim të nenit 283/a paragrafi i tretë i Kodit Penal Shqiptar.

Nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Apelit Milano ka rezultuar se shtetasi V. H. , në bashkëpunim me persona të tjerë nga Belgjika dhe Shqipëria, ka importuar ilegalisht në shtetin italian sasi të konsiderueshme heroine gjatë vitit 2001 dhe konkretisht:

- Në datë 11.08.2001, në Lagjen “Giambellino” të Milanos është sekuestruar sasia prej 7.750 kg. heroinë.
- Në datë 13.10.2001, në vendin e quajtur Ivrea, në autoveturën me targa xx xxxxxx, është sekuestruar sasia prej 9.50 kg. heroinë.
- Po në të njëjtën periudhë në shtetin italian, në autoveturën tip “Mercedes”, me ngjyrë të zezë, me targa belge xxx xxx, është sekuestruar sasia prej 5 kg. heroinë
- Në datën 09.11.2001, në Rrugën “Vigevano” Nr. 9 Milano, është sekuestruar sasia prej 8.250 kg. heroinë.

Duke e konsideruar shtetasin V. H. subjekt të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 **“Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese Kundër Pasurisë”**, (neni 3 pika 1 gërma “ç”), organi i prokurorisë ka kryer veprime hetimore në lidhje me zbulimin, identifikimin dhe verifikimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, aktiviteteve ekonomike të tij dhe personave të lidhur me të (nenet 3 pika 2 gërma “a”; 6, 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 i cili, më poshtë do të citohet thjesht Ligji).

Në kuadër të hetimit pasuror nuk ka rezultuar që shtetasi V. H. të ketë në disponim pasuri të luajtshme apo të paluajtshme. Duke u shtrirë hetimi edhe mbi personat lidhje e afërt gjinore, ka rezultuar se babai i tij, shtetasi D. H., si subjekt i Ligjit në bazë të nenit 3 pika 2 gërma «a» e tij, dispononte pasuritë e mëposhtme:

1. Njësi tregëtare, me sipërfaqe xxx.x mx, ndodhur në katin përdhe të një pallati 9-katësh, në Lagjen “xxxxxxx” të qytetit të xxxxx, blerë prej tij në vitin xxxxx kundrejt çmimit prej x.xxx.xxx lekë.

2. Njësi tregëtare, me sipërfaqe xx.x mx, ndodhur po në katin përdhe të pallatit x-katësh, në Lagjen “xxxxxxx” të qytetit të xxxxx, blerë prej tij në vitin xxxxx kundrejt çmimit prej x.xxx.xxx lekë.

Në kuadër të hetimit pasuror ka rezultuar gjithashtu se, shtetasi D. H. dispononte pasuri të tjera të paluajtshme, të fituara në zbatim të Ligjit Nr. 7501 dhe, një llogari bankare në Bankën “Raiffeisen” të cilat, nga ana e prokurorit janë përjashtuar nga rrethi i pasurive që duhet t’i nënshtroheshin masave parandaluese .

Objekt i hetimit pasuror, kanë qënë edhe aktivitetet ekonomike, tregëtare, të shtetasit V. H. dhe të afërmeve të tij, në zbatim të nenit 3 pika 2 gërma “a” të Ligjit. Nga këto veprime hetimore ka rezultuar si më poshtë:

Shtetasi V. H. , me Vendimin Nr. 139 datë 20.02.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, ka qënë i rregjistruar si person fizik me objekt të veprimtarisë së tij “Bar-Kafe” dhe, më pas është ç’rregjistruar për shkak të mospajisjes me Nipt. Ky fakt është konfirmuar nga Qendra Kombëtare e Rregjistrimit të Biznesit, me Shkresën e saj Nr. 5287/1 datë 18.05.2010.

Mbi kërkesën e Prokurorisë pranë saj, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane, me Vendimin Nr. 16 datë 27.12.2010, bazuar në nenin 11 të

Ligjit ka vendosur masën e sekuestros mbi pasurinë objekt konfiskimi. Ky vendim është lënë në fuqi me Vendimin Nr. 11 datë 07.02.2011 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tirane.

Në vendosjen e sekuestros (shih vendimin e mësipërm) gjykata ka arsyetuar qënien e shtetasit V. H. dhe të babait të tij, shtetasit D. H. , si subjekte të zbatimit të Ligjit, në referim të nenit 3 pika 1 gërma “ç” dhe pika 2 gërma “a” të tij. Është konstatuar prej saj ekzistenca e kriterëve të përgjithshme për vendosjen e masës së sekuestros që lidhen me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në indicje, për pjesmarrje të shtetasit V. H. në veprimtari kriminale që përfshihet në fushën e zbatimit të këtij Ligji si dhe, e zotërimit të pasurive që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave (të parashikuara si të tilla në nenin 11 pika 1 gërma “a” dhe “b”). Gjithashtu, është arsyetuar edhe ekzistenca e kriterit të veçantë që lidhet me praninë e rrezikut të tjetërsimit apo humbjes së pasurive (e parashikuar në gërmën “a” të pikës 1 të nenit 11 të Ligjit).

Sipas vendimit, në kushtet kur shtetasi V. H. është dënuar nga Gjykata e Apelit Milano Itali për kryerje të veprave penale “Organizata kriminale dhe “Trafikimi i narkotikëve”, vendim i cili është njohur nga gjykata shqiptare (që ka bërë konvertimin e dënimit duke e dënuar përfundimisht atë, për kryerje të veprës penale “Trafikimi i narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a paragrafi i tretë i Kodit Penal), është tejkalluar kufiri i ekzistencës së indicjeve që kërkon ligji për zbatimin e tij. Nuk jemi më para indicjeve, mbi të cilat të ngrihet dyshimi por, përpara fajësisë dhe dënimit përfundimtar (kriteri i parë i përgjithshëm).

Shtetasi D. H. , si babai i të dënuarit, për shkak të lidhjes së afër gjinore me të është subjekt i Ligjit dhe për pasojë, pasuria e tij i nënshtrohet zbatimit të tij. Shtetasit V. dhe D. H. si dhe familjarët e tyre nuk kanë rezultuar të kenë të regjistruar aktivitete tregëtare fitimprurëse dhe të ardhura të tjera që të mund të justifikonin shumën e parave të përdorura për blerjen e pasurive të palujtëshme, objekt sekuestrimi (kriteri i dytë i përgjithshëm). Ka ekzistuar rreziku real dhe potencial për tjetërsimin e pasurive të sekuestruara. Me marrjen dijani të procedimit pasuror të filluar ndaj shtetasit V. H., zotëruesi faktik i pasurive, babai i tij, i ka patur të gjitha mundësitë për të kryer veprime për shmangien e tyre nga një konfiskim i mundshëm (kriteri i veçantë i parashikuar në pikën 1 gërma “a” të nenit 11).

Në datë 23.06.2010 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane, bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, ka paraqitur para kësaj gjykate kërkesën me objekt konfiskimin e pasurive të përshkruara hollësisht në pjesën hyrëse të vendimit.

Në kushtet kur barra e provës, në zbatim të këtij Ligji, i përket personit pasuria e të cilit kërkohet të konfiskohet (pika 3 e nenit 21 të Ligjit) gjatë gjykimit, nga ana e mbrojtësit të shtetasve V. dhe D. H. u paraqitën me cilësinë e provës:

1. Dëshmia e dëshmitarëve N. H. dhe M. H., të cilët deklaruan rreth aktivitetit bujqësor dhe blektoral të ushtruar nga shtetasi D. H. dhe familja e tij, në fshatin Drizë, pas viteve 1990 dhe në vazhdim.

Sipas dëshmitarit N. H. , banor i fshatit Drizë, D. që nga viti 1991 e deri në vitin 2005 ka patur në pronësi një vresht nga i cili ka siguruar të ardhura nga shitja në tregun privat e rrushit, verës dhe rakisë. Në vitin 2005 D. e ka prishur vreshtin dhe ka mbjellë pemë frutore. Ai është marrë gjithashtu edhe me rritjen e viçave dhe të pulave të detit të destinuar për shitje. Nga shitja e një viçi ai ka përfituar shumë prej 700 000 lekësh (të vjetra). Në vitin 1994 apo 1995, së bashku kanë shkuar në Greqi, në Agrinjo, për një periudhë njëmuajore (në kohën kur D. kishte marrë lejen e zakonshme) ku kanë punuar në ndërtim dhe janë paguar në shumë 10 000 lekë në ditë (të vjetra).

Sipas dëshmitarit M. H. , banor i fshatit Zhupan Fier i ndodhur shumë pranë me fshatin Drizë, D. pasi viteve 90 ka përfituar dy dynym vreshtë me të cilën është marrë për rreth katër apo pesë vjet duke bërë tregëti me rrushin, verën dhe rakinë. Prodhimi sipas tij është llogaritur në 16-18 kuintal për dynym. Krahas kësaj veprimtarie D. është marrë edhe me bagëti, me shitje lopësh dhe delesh.

2. Vërtetimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave SH.A, Njësia e Biznesit të Menaxhimit të Infrastrukturës Hekurudhore Durrës Nr. 936/3 Prot datë 26.09.2011 dhe Nr. 897 Prot datë 16.09.2011.

Nëpërmjet tyre u vërtetua fakti se shtetasi D. H. është punonjës i N/Njësia Mirëmbajtjes Fier që prej vitit 1993, me pagë mujore mujore 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

3. Akti i marrjes së tokës në pronësi Nr. 31641 datë 18.03.1997.

Nga përmbajtja e tij rezultoi fakti se shtetasi D. H. ka përfituar, nga Ligji Nr. 7501 “Për tokën”, tokë me sipërfaqe totale 18 867 m².

4. Dy kontrata huaje

Sipas Kontratës së Huasë me Nr. xx/xxx Regj datë 05.04.1996, me palë Huadhënës D. H. dhe Huamarrëse Shemsije Kadrija, Presidente e Shoqërisë Tregëtare Private “xxxxxxx” SH.P.K ka rezultuar se, huadhënësi i ka dhënë huamarrëses shumën prej 100 000 (njëqind mijë) lekë, me afat gjashtë mujor, duke filluar ai në datë 05.10.1996 dhe përfunduar në datë 05.04.1997, me këst mujor x %, e llogaritur në shumën 8 000 (tetëmijë) lekë dhe, datë tërheqje datën x të çdo muaji.

Sipas Kontratës së Huasë me Nr. xx/xxx Regj datë 06.09.1996, me palë Huadhënës D. H. dhe Huamarrëse Sh. K. , Presidente e Shoqërisë Tregëtare Private “xxxxxxx” SH.P.K ka rezultuar se, huadhënësi i ka dhënë huamarrëses shumën prej 300 000 (treqind mijë) lekë, me afat gjashtë mujor duke filluar ai në datë 06.09.1996 dhe përfunduar në datë 06.03.1996, me këst mujor 8 % ,e llogaritur në shumën 24 000 (njëzet e katër mijë) lekë dhe, datë tërheqje datën 6 të çdo muaji.

5. Deklarata Noteriale Nr. 260 Rep Nr. 126 Kol datë 24.08.2011 me deklarues shtetasit D. H. dhe F. H.

Nga përmbajtja e saj ka rezultuar deklarimi i shtetasit D. H. për shitjen, në Vitin 1998, të sipërfaqes së ullishtës prej xxx mx tek shtetasi F. H. , kundrejt çmimit prej 800 000 lekësh (të paguara jashtë zyrës së noterisë) dhe, deklarimi i këtij të fundit për blerjen e saj. Në funksion të provueshmërisë së këtij deklarimi u paraqitën gjithashtu fotografi me pamje të ullishtës dhe shtëpisë së ndërtuar mbi të si dhe, Vërtetimi i Kryeplakut të fshatit Drizë, Komuna Qendër, datë 25.09.2011, ku konfirmohej fakti i ndërtimit të banesës.

6. Fotografi me pamje të objektit të konfiskimit në gjendjen në të cilin ai ndodhej në momentin e blerjes.

Në përfundim të gjykimit **prokurori A. Xh.** paraqiti pretendimet dhe kërkimet përfundimtare. Sipas tij:

Pasuritë e rregjistruara në emër të babait të të dënuarit V. H. janë krijuar pas vitit 2001 (datës 11.08.2011) kohë në të cilën është provuar fillimi i aktivitetit kriminal të tij.

Shtetasi D. H. , pavarësisht pretendimeve të tij për nxjerrjen e të ardhurave, nuk paraqiti prova shkresore të formës dokument, mandat apo faturë që të vërtetonte ato. Paga që përfiton shtetasi D. H. nuk i mjafton familjes së tij për të përballuar shpenzimet minimale për jetesë. Në lidhje me kontratat e huasë nuk u paraqitën fatura apo mandate pagese që të provonin tërheqjet që ai ka bërë pranë kësaj firme piramidale. Mbeti i paprovuar pretendimi për të ardhurat e siguruara nga puna në bujqësi, blektori dhe emigracion. Gjithashtu, i paprovuar mbeti edhe pretendimi i shitjes së sipërfaqes së tokës tek shtetasi F. H. , në mungesë të provave shkresore dhe të dëshmitarëve.

Për sa më sipër, duke pretenduar se shtetasit V. dhe D. H. nuk arritën të provonin ligjshmërinë e prejardhjes së pasurive të sekuestruara, prokurori kërkoi konfiskimin e tyre dhe të pajisjeve të ndodhura në to.

Përfaqësuesi i posaçëm i shtetasit të dënuar V. H. dhe babait të tij, shtetasit D.H. , **Av. Xh. M.** paraqiti pretendimet dhe kërkimet përfundimtare. Sipas tij:

1.Organi i prokurorisë kishte detyrimin ligjor të paraqiste para gjykatës prova për të provuar se pasuritë, objekt konfiskimi, nuk rridhnin nga puna e shtetasit D. H. por e djalit të tij, të dënuarit V. H. Pasi organi i prokurorisë të përmbushte këtë detyrim na binte barra e provës për të kundërshtuar provat e prokurorisë.

2. Pallati x-katësh, në të cilin ndodhen objektet e konfiskimit, ka filluar të ndërtohet që në vitin 1999 dhe, shtetasi D. H. , me para në dorë, ka prenotuar dhe blerë që në këtë kohë prodruhet, të përshtatura më vonë si njësi

tregëtare.

3. Në vitin 1998 D. i ka shitur shtetasit F. H., kundrejt çmimit prej 800 000 lekë lekë, një sipërfaqe ullishte prej xxx mx, pa akt noterial dhe, nga qarkullimi është përfituar disa fish vlera e saj.

4. Shtetasi D. H. , ka qarkulluar në aktivitete të ndryshme të parregjistruara të ardhurat nga emigracioni dhe nga përqindjet e përftuara nga firmat piramidale.

5. Provat me dëshmitarë provuan të ardhurat e siguruar nga shtetasi D. H. dhe familja e tij, nga puna në bujqësi dhe blektori.

Përsa më sipër, duke pretenduar se pasuritë objekt konfiskimi janë rezultat i të ardhurave nga puna dhe kursimet e shtetasit D. H. dhe familjes së tij, mbrojtësi kërkoi rrëzimin e kërkesës së prokurorisë si të pabazuar në ligj dhe në prova dhe revokimin e masës së sekuestros të vendosur mbi to.

Gjykata, në analizë të provave të paraqitura dhe marra në gjykim, konkludon se kërkesa e Prokurorisë për konfiskimin e dy njësive tregëtare, së bashku me pajisjet të ndodhura në to, në zotërim faktit të shtetasit D. H. , është e drejtë, e bazuar në ligj dhe si e tillë duhet të pranohet.

Në pikën 1 të nenit 24 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen kundër krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” parashikohet shprehimisht:

“Gjykata vendos konfiskimin e pasurive kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) kur ka dyshime të arsyeshme, bazuar në indicje, për pjesmarrjen e personit në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji;

b) kur nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personi nuk justifikon zotërimin e pasurive ose të të ardhurave, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre; dhe

c) kur rezulton se pasuria është drejëdrejt ose tërthorazi në zotërim të pjesshëm apo të plotë të personit”.

Në interpretim dhe zbatim të kësaj dispozite Gjykata çmon se, për vendosjen e masës parandaluese të konfiskimit, është e domosdoshme vërtetimi i ekzistencës njëkohësisht të tre kushteve që kanë të bëjnë: **1.** Me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, bazuar në indicje për pjesmarrje në veprimtari kriminale të

parashikuar në nenin 3 të Ligjit, që bën fjalë për fushën e zbatimit të tij; **2.** Me prejardhjen e paligjshme të pasurisë apo mosjustifikimin e zotërimit të saj, referuar nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të tjera të ligjshme të deklaruara dhe **3.** Me zotërimin e plotë apo të pjesëshëm të pasurisë nga personi i proceduar drejtpërdrejt apo tërthorazi.

Në çështjen në gjykim, mbi bazën e provave të paraqitura, të marra dhe të shqyrtuara në kushtet e debatit gjyqësor, gjykata konkludon për ekzistencën njëkohësisht të tre kushteve të sipërpërmendura për vendosjen e masës së konfiskimit mbi dy njësitë tregëtare, dhe pajisjet brenda tyre, të përshkruara në pjesën hyrëse të vendimit dhe, në procesvebalin e inventarizimit, përpiluar nga përmbaruesi në datë 07.01.2011.

Së pari: Ashtu sikurse është arsyetuar në Vendimin Nr 16 datë 27.12.2010 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tirane, me të cilin është vendosur masa e sekuestros mbi pasurinë objekt konfiskimi (i përmendur më sipër), për shtetasin **V. H. nuk mund të bëhet më fjalë për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, në nivelin e indicjeve, për pjesmarrje në veprimtarinë kriminale në fushën e trafikimit të narkotikëve, sikurse e kërkon Ligji, neni 3 pika 1 gërma “ç”e tij pasi, në kushtet e dhënies së dënimit dhe të vuajtjes aktualisht të tij, është provuar plotësisht tej çdo dyshimi të arsyeshëm, pjesmarrja e tij në këtë veprimtari.**

Shtetasi V. H. me Vendimin Penal Nr. 2858 datë 13.06.2005 të Gjykatës së Apelit të Milanos Itali është deklaruar fajtor dhe dënuar me njëzet e katër vjet burgim për kryerje të veprave penale “Organizata kriminale dhe “Trafikimi i narkotikëve”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me Vendimin Nr. 404, datë 14/11/2008 ka njohur vendimit penal të Gjykatës së Apelit të Milanos-Itali, për të dënuarin V. H., vendim i cili është lënë në fuqi me Vendimin Nr.51, datë 12/03/2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë

Së dyti: Me provat e paraqitura dhe të marra në gjykim, **shtetasit V. dhe D. H. nuk arritën të vërtetojnë prejardhjen e ligjshme të pasurisë objekt konfiskimi.**

Në zbatim të pikës 3 të nenit 21 të Ligjit, nga përfaqësuesi i posaçëm i të dënuarit V. H. dhe mbrojtësi i shtetasit D. H. u paraqitën me cilësinë e provës, dy dëshmi, vërtetimi i punësimit dhe i të ardhurave të shtetasit D. H., dy kontrata huaje, deklarata noteriale për shitjen e sipërfaqes së ullishtës, vërtetimi i kryeplakut të fshatit për banesën e ndërtuar nga F. H. , fotografi të shtëpisë së ndërtuar mbi këtë sipërfaqe dhe, të objekteve të

konfiskimit në momentin e blerjes. Më poshtë po i analizojmë konkretisht:

Dëshmitarët H. H. dhe M. H. deklaruan para gjykatës për aktivitetin bujqësor dhe blektoral të familjes së shtetasit D. H. dhe, dëshmitari H. edhe për periudhën prej një muaji të emigracionit të tij në Greqi, së bashku me D. Pavarësisht deklaramit, dëshmitarët nuk ishin në gjendje të dëshmonin për nivelin konkret të të ardhurave të siguruara nga ky aktivitet. U fol për pronësinë e D. mbi një vresht, për rrush, raki dhe verë të prodhuar dhe shitur, për lopë, dele dhe viça të mbajtur dhe shitur por, nuk u dëshmuua konkretisht sesa të ardhura janë siguruar prej tyre dhe sa janë kursyer për tu përdorur më pas për blerje të pasurisë objekt konfiskimi. Duke patur parasysh punësimin e vazhdueshëm të shtetasit D. H. , si teknik mirëmbajtje në N/Njësinë e Mirmbajtjes së Linjave, me një pagë minimale prej 25 000 lekësh, të vërtetuar me vërtetimet përkatëse të paraqitura në gjykim, nisur nga fakti se me punët në bujqësi është marrë ai dhe bashkëshortja e tij, gjykata konkludon se niveli i të ardhurave të siguruara nga ky aktivitet ka qënë i ulët. Nëse ky nivel do të kishte qënë ashtu sikurse u pretendua, shtetasi D. H. nuk do të detyrohej të provonte fatin e tij në emigracion, në periudhën prej një muaji të lejës së tij të zakonshme.

U paraqitën si provë dy kontrata huaje, të lidhura në Vitin 1996, ndërmjet shtetasit D. H. dhe Firmës Piramidale “xxxxxxx”, për shumat 100 000 dhe 300 000 lekë. Kontratat e huasë provuan thjesht faktin e dhënies së këtyre shumave kundrejt një interesi por, të pashoqëruara me mandate apo dokumenta të tjera shkresore ato nuk arritën të provonin përfitimin e shtetasit D. H. nga kryerja e këtij veprimi. Duke patur parasysh faktin që qytetarët, pas rrënies së firmave piramidale, në vitin 1997, humbën paratë e depozituara pranë tyre, për gjykatën kontratat e paraqitura mbetën pa vlerë provuese, në interes të çështjes objekt gjykimi.

U paraqit si provë deklarata noteriale e vitit 2011, ku shtetasit D. H. dhe F. H. deklarorin shit-blerjen, e realizuar midis tyre, të një sipërfaqe ullishte, prej xxx mx, kundrejt çmimit prej 800 000 lekësh. Në funksion të provueshmërisë së faktit se mbi këtë sipërfaqe toke shtetasi F. H. ka ndërtuar një shtëpi banimi, u paraqitën një vërtetim i Kryeplakut të fshatit Drizë, Komuna Qendër, datë 25.09.2011 si dhe, disa fotografi të banesës.

Për gjykatën deklarata e paraqitur nuk mund të provojë kryerjen e veprimit të

shit-blerjes ndërmjet shtetasve D. H. dhe F. H. Bazuar në nenin 83 të Kodit Civil, kalimi i pronësisë mbi sendet e palujtëshme duhet të bëhet me akt noterial pasi, në të kundërt ai është i pavlefshëm. Duke pranuar të provuar faktin që mbi sipërfaqen e ullishtës, në pronësi të shtetasit D. H. , shtetasi F. H. ka ndërtuar shtëpinë e tij, gjykata e konsideron të paprovuan veprimin e shit-blerjes së saj. Për këtë sipërfaqe toke, në mungesë të aktit noterial të xxxx-xxxx, është e arsyeshme të mendohet që ajo edhe mund të jetë falur, të jetë shkëmbyer etj. Por, edhe sikur të pranojmë të provuar për një moment veprimin juridik të shit-blerjes, vlera e përfituar prej shitjes nga shtetasi D. H., në masën xxx xxx lekë, është larg vlerës së objekteve të blera prej tij (x. xxx.xxx lekë) dhe që janë objekt konfiskimi.

Nga ana e mbrojtjes u paraqitën si provë fotografi të objektit të konfiskimit në momentin e blerjes me pretendimin se, prona e blerë nuk mund të konsiderohet si pronë trafikanti për gjendjen në të cilën ndodhej dhe vlerën e saj. Por, për gjykatën mbrojtja nuk ishte në gjendje të argumentonte se me ç'farë vlerash monetare gjendja fillestare e pronës u ndryshua dhe përmirësua për tu përshtatur si bar-kafe. Mbrojtja u mjaftua me deklarimin se, ndërsa objektet u blenë me të ardhurat nga puna dhe kursimet e shtetasit D. H., përmirësimi dhe përshtatja u bë nga djali i tij, V. H. , pas kthimit nga emigracioni pa përmbysur kështu detyrimin e këtij të fundit për të justifikuar të ardhurat.

Së treti: Pasuria objekt konfiskimi është nën zotërimin e drejtpërdrejtë të shtetasit D. H. i cili është i proceduar tërthorazi si për shkak të lidhjes së afërt gjinore me shtetasin V. H. , duke qënë në këtë mënyrë subjekt i zbatimit të Ligjit, ashtu edhe për shkak të zotërimit faktit të pasurisë.

Në bazë të procesverbalit “Për kryerjen e veprimeve përmbarimore gjatë ekzekutimit”, datë 07.01.2011, të Zyrës së Përmbarimit Fier (bashkëngjitur Relacionit Nr. 189 Prot datë 25.01.2011 të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara) ku janë inventarizuar pajisjet e ndodhura në dy objektet njësi tregëtare (të bashkuara në një) si dhe, fotografive bashkëngjitur ka rezultuar se shtetasi D. H. është zotërues faktik i saj.

Përsa më sipër, duke qënë se ekzistojnë tre kushtet e vendosjes së masës parandaluese të konfiskimit Gjykata, bazuar në nenin 24 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen kundër krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, çmon se kërkesa e

Prokurorisë me objekt konfiskimin e dy njësive tregëtare, njëra me sipërfaqe xxx.x mx dhe tjetra me sipërfaqe xx.xx.mx, të ndodhura në katin përdhes të pallatit x-katësh, në Lagjen “xxxxxxx” xxxx, duhet të pranohet.

Për sa më sipër, gjykata gjeti të pabazuara pretendimet e përfaqësuesit të posaçëm dhe mbrojtësit të shtetasve V. dhe D. H.

1. Pretendimin se organi i prokurorisë kishte detyrimin ligjor të paraqiste para gjykatës prova, për të provuar se pasuritë objekt konfiskimi nuk rridhnin nga puna e shtetasit D. H. por e djalit të tij, të dënuarit V. H. , Gjykata e gjen në kundërshtim të plotë me nenin 21 pika 3 të Ligjit, në të cilin parashikohet shprehimisht: *“Barra e provës për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi”* si dhe, me Vendimin Nr. 4 datë 23.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese. Në vendim, duke specifikuar ndryshimet që ekzistojnë midis sekuestrimit dhe konfiskimit, është sqaruar se, gjatë shqyrtimit të masës së konfiskimit personi, pasuria e të cilit kërkohet të konfiskohet, ka barrën e provës për të justifikuar prejardhjen e ligjshme të saj. Një parashikim i këtij detyrimi në ligj është i lidhur xxxxxxx me qëllimin e tij për parandalimin dhe goditjen kundër krimit të organizuar dhe trafikimit, përmes ngrirjes dhe konfiskimit të pasurive.

2. U pretendua se shtetasi D. H. i ka blerë objektet e konfiskimit që në Vitin 1999, në momentin që pallati x-katësh, në të cilin ato ndodhen, ka filluar të ndërtohet por, nuk ka mundur të bëjë aktin noterial. Ky pretendim bie në kundërshtim me Kontratën e Shit-blerjes Nr. xxx Rep Nr. xxx Kol datë 04.03.2002 me palë Shitëse R. H. dhe L. Gj. , palë blerëse D. H. dhe objekt shit-blerja e dy njësive tregëtare, të ndodhura në katin përdhes të objektit x-katësh. Ashtu sikurse rezulton nga kontrata, blerja nga shtetasi D. H. nuk është bërë tek firma e ndërtimit por, tek qytetarë të thjeshtë të cilët, nga ana e tyre, janë bërë zotërues të pronës në datë 29 Dhjetor të Vitit 2000.

3. Pretendimet për përfitime të siguruara nga vënia në qarkullim e shumave të parave, të përfituara nga shitja e sipërfaqes së ullahtës tek shtetasi F. H., nga emigracioni dhe përqindjet e përfituara nga firmat piramidale, në mungesë të paraqitjes së provave mbetën të paprovuara.

4. I paprovuar mbeti edhe pretendimi për sigurimin e të ardhurave të mëdha nga aktiviteti bujqësor dhe blektoral. Dëshmitarët e paraqitur, ashtu sikurse u trajtua më sipër, nuk ishin të gjendje të provonin se ç’farë të ardhurash konkrete ka

siguruar shtetasi D. H. nga prodhimet në vreshtë apo, nga mbajtja dhe shitja e bagëtive.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenet 24 pika 1, 25, 26 e 28 të Ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen kundër krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, nenet 299 e 310 të Kodit të Procedurës Civile.

V E N D O S I

Pranimin e kërkesës.

Konfiskimin dhe kalimin në favor të shtetit të pasurive:

1. Pasuri e paluajtshme “xxxxx xxxxxx”, me sipërfaqe xxx.x mx, Zona Kadastrale xxxx, me numur pasurie x/xx-xx, Vol.x, Faqe xx, Indeksi i hartës xx-xx-xx, në zotërim të shtetasit D. H., e ndodhur në katin përdhes të një pallati x-katësh, në Lagjen “xxxxxxx” të qytetit të Fierit, së bashku me pajisjet brenda saj, të pasqyruara në Procesverbalin e Zyrës së Përmbarrimit Fier “Për veprimet përmbarrimore gjatë ekzekutimit” datë 07.01.2011.

2. Pasuri e paluajtshme “xxxxx xxxxxx”, me sipërfaqe xx.x mx, Zona Kadastrale xxxx, me numur pasurie x/xx-xx, Vol.x, Faqe xx, Indeksi i hartës xx-xx-xx, në zotërim të shtetasit D. H., e ndodhur në katin përdhes të një pallati x-katësh, në Lagjen “xxxxxxx” të qytetit të Fierit, së bashku me pajisjet brenda saj, të pasqyruara në Procesverbalin e Zyrës së Përmbarrimit Fier “Për veprimet përmbarrimore gjatë ekzekutimit” datë 07.01.2011.

3. Për administrimin e përdorimin e këtyre pasurive ngarkohet **Z. E. B.**, administrator në Agjencinë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë dhe, për ekzekutimin e këtij vendimi Zyra e Përmbarrimit Fier.

4. Shpenzimet procedurale në masën 230.261.84 (dyqind e tridhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një lekë dhe tetëdhjetë e katër qindarka) si dhe, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen solidarisht shtetasve V. H. dhe D. H.

Kundër vendimit lejohet e drejta e ankimit, brenda afatit 15 ditor nga e nesërmja e shpalljes në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

U shpall në Tirane, sot në datë 03.11.2011.

SEKRETARE

ANDINA KAJA

GJYQTARE

LILJANA BAKU

